



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE

RELACION

**PËR MIRATIMIN E FALJES SË TARIFAVE VENDORE PËR NJË KATEGORI
TË CAKTUAR SUBJEKTESH.**

Të nderuar këshilltar !

Këshilli Bashkiak me Vendimin nr.60 datë 18.12.2019 ka miratuar paketën fiskale në të cilën janë përcaktuar taksat dhe tarifatat për subjektet që ushtojnë aktivitet tregtar në Bashkinë Berat.

Në kushtet e krijuara, filluar nga marsi i vitit 2020 prej situatës pandemike, jemi detyruar që në kërkesat tona për implementimin e saj të jemi të vëmendshëm dhe të ndërmarrim masat e duhura në kohë për tju përgjigjur situatës.

Njëkohësisht ne jemi të vëmendshëm edhe ndaj kërkesave të biznesit që kanë të bëjnë me implementimin sa më korrekt të paketës fiskale, kërkesa këto që i shërbejnë përmirësimit të saj në vijimësi gjatë implementimit.

Sa më sipër, të ndodhur në kushtet kur:

- Nga analiza e të dhënave marrë nga Drejtoria Rajonale e Tatimore konstatohet se shërbimi i transportit publik udhëtarëve mbi 8+1 dhe transporti urban për periudhën Qershor Dhjetor 2020, si rezultat i implementimit të kufizimeve të numrit të udhëtarëve dhe kufizimit të orareve të lëvizjes, ky shërbim ka rezultuar në kosto. Pasojë kjo që ka ndikuar në realizimin nën nivel mesatar të të ardhurave dhe mungesë të kesh-it të këtyre bizneseve.

Gjithashtu kjo mungesë likuiditeti, ka sjellë jo vetëm mos likuidimit detyrimeve për njësinë e qeverisjes vendore por edhe ndaj atyre tatimore, e për më tepër dhe ndaj likuidimit në kohë të pagave të punonjësve.

Gjithashtu ky shërbim për një periudhë kohe ka punuar edhe nën kosto për të mos e pezulluar këtë shërbim

- Referuar edhe njërive të qeverisjes vendore të tjera, nga monitorimi që kemi bërë për disa bashki rezulton se këtij shërbimi i janë falur tarifatat vendore për një periudhë 10 mujore. Nga ana jonë gjatë vitit 2020 kemi vendimuar faljen e këtyre



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE

tarifave vendore për një periudhë 3-mujore, përkatësisht për muajt Mars, Prill dhe Maj 2020.

- Në situatën aktuale ky shërbim rezulton me detyrime ndaj bashkisë për të dyja këstet e vitit 2020, detyrim ky në vlerën 2,085,278 lekë. Sa shikohet kjo është një debi në një vlerë jo të pa konsiderueshme kur kësaj vlerë i shtohen edhe detyrimet që vijnë për vitin 2021.

Referuar sa trajtojmë, në gjykimin tonë ky biznes nuk e ka fuqinë ekonomike për ta përballuar dhe për të vijuar shërbimin në kushte normale. Për këtë arsye ne gjykojmë se duhet ta mbështesim këtë shërbim duke i falur një pjesë të këtij detyrimi që fillon nga muaji Qershor 2020 deri në muajin Dhjetor 2020. Kjo mendojmë se e lehtëson këtë shërbim për të krijuar kushte për mos thellim të detyrimeve dhe lehtësi në keshin e tij për të ushtruar aktivitetin drejt normalizimit. Periudha që propozojmë të falet i përket një periudhe pandemike që pati dhe trendin e saj rritës sidomos duke filluar nga muaji Shtator- Dhjetor 2020.

Kjo falje është në vlerën 2,085,278 lekë në buxhetin e vitit 2021 është pasqyruar në zërin e të ardhurave Debitorë të tjerë të mbartur.

Për sa më sipër propozojmë:

1. Faljen e Tarifave për subjektet që ushrojnë aktivitet në fushën e transportit të udhëtarëve mbi 8+1 dhe transportin urban për periudhën Qershor 2020 deri në Dhjetor 2020.
2. Subjektet të cilët kanë kryer pagesën e tarifave vendore periudhën Qershor 2020 deri në Dhjetor 2020, në fushën e transportit të udhëtarëve mbi 8+1 dhe transportin urban do ti kompesohet kjo pagesë për të njëjtin afat kohor në vitin 2021.

Efekti financiar për faljen e tarifave është në vlerën 2,085,278 lekë.

DREJTOR I TAKSAVE DHE I TARIFAVE

Sokol Toska